


VAKSINIMI I FËMIJËVE KUNDËR COVID-19



Vlora Ismaili Jaha

Profesoreshë e
Pediatriisë
Fakulteti i Mjekësisë
Universiteti i Prishtinës

Specialiste e Pediatriisë
Klinika e Pediatriisë
SHSKUK

Korrespondenca:
vlorajaha@gmail.com

COVID-19, infeksioni i shkaktuar me SARS CoV-2, është sëmundje që prek edhe fëmijët. Sipas AAP-së në SHBA 28% e të infektuarve janë fëmijë. Në Klinikën e Pediatriisë së QKUK-së prej qershorit të vitit 2020 deri në gusht të vitit 2021 kanë qenë të hospitalizuar 180 fëmijë, prej të cilëve me letalitete kanë përfunduar 3 fëmijë. Vetëm gjatë gushtit të vitit 2021 në mënyrë ambulatore janë trajtuar 228 raste.

Arsyeja për sëmundje më të lehtë, ndonjëherë asimptomatike, mendohet të jenë infeksionet e shpeshta respiratore me viruse të tjera respiratore dhe me COVID-19 në moshat pediatrike. Sëmundja te fëmijët, megjithatë, mund të jetë e rëndë, për çka fëmijët kanë nevojë të hospitalizohen, ndonjëherë edhe në Repartet e Kujdesit Intenziv.

Fëmijët, të cilat kanë obezitet, diabet dhe astmë, janë me rrezik më të madh për të zhvilluar sëmundje më të rëndë, gjithashtu edhe fëmijët me defekte në zemër, sëmundje gjenetike apo të lidhura me problemet e SNQ-së.

Simptomat me të cilat fëmijët me COVID-19 janë paraqitur në Klinikën e Pediatriisë kanë qenë: simptoma gastrointestinale (mundim, vjellje, dhembje barku dhe diarre), temperatura, kollja, e cila pastaj bëhet produktive, ethe, dhembje e muskujve dhe e nyjeve, dhembje koke, dhembje fyti, nxënie e hundës, lodhje e plogështi, humbje e shijes dhe e nuhatjes.

Vaksinimi i moshave pediatrike. Disa shtete kanë zhvilluar dhe kanë testuar vakcina për moshat pediatrike. Testimet për fëmijët më të vegjël se 3 vjeç janë kryer për 2 vakcina të inaktivuara, por ato nuk janë aprovuar dhe kështu vazhdon hulumtimi klinik për siguri edhe për efikasitet. Prej 5 dhjetorit 2021 është aprovuar vakcina mRNA në moshat 5-11 vjeç, e cila jepet në dy doza në interval prej 8 javësh dhe është dozë më e ulët se doza për fëmijë më të mëdhenj - 10 microgram krahasuar me 30 µg të mbi 12 vjeçarve. Hulumtimet dëshmojnë që është efektive deri 91% për të parandaluar infeksionin me COVID-19. Për moshat 12-17 vjeç janë aprovuar 2 vakcina të prodhuara nga Pfizer dhe nga Moderna. Vakcina e Pfizerit, e cila përmban dozën si të rriturit, jepet në dy doza në diferencë kohore 3-6 javë pas dozës së parë (doza e tretë preferohet te fëmijët me imunitet të komprometuar). Hulumtimet tregojnë efikasitetin e vaksinës 100%. Vakcina Moderna gjithashtu jepet në dy doza në periudhë kohore 4-6 javë (doza e tretë preferohet te fëmijët me imunitet të komprometuar).

Vaksinimi i fëmijëve të moshave mbi 16 vjeç bëhet me doza të të rriturve dhe mendohet që efikasiteti i tyre arrin deri në 91%.

Vaksinimi i të gjithë popullatës është treguar fitimprurës në aspektin mjekësor, përfshirë edhe

fëmijët e adoleshentët, por ende mbeten për t'u përcjellë e për t'u raportuar edhe efektet negative të vogla, siç janë: dhembja lokale, lodhja, kokëdhembja apo atyre të rralla si miokarditi, sidomos te djemtë e moshave 16-24 vjeç.

Vaksinimi, përveç që mbron fëmijët, preferohet edhe për shkak se fëmija asimptomatik, mund të jetë burim infeksioni për të rriturit.

Literatura:

1. American Academy of Pediatrics. Children and COVID 19 – State level report. Last updated 21.12.2021. <https://www.aap.org/en/pages/2019-novel-coronavirus-covid-19-infections/children-and-covid-19-state-level-data-report/>
2. COVID-19 (coronavirus) in babies and children. Mayo Clinic. Last updated
3. Hong H, et al. Clinical characteristics of novel coronavirus disease 2019 (COVID-19) in newborns, infants and children. *Pediatrics & Neonatology*. 2020; doi: 10.1016/j.pedneo.2020.03.001
4. Lu X, et al. SARS-CoV-2 infection in children. *New England Journal of Medicine*. 2020; doi: 10.1056/NEJMc2005073
5. Viner RM, et al. Susceptibility to SARS-CoV-2 infection among children and adolescents compared to adults: A systematic review and meta-analysis. *JAMA Pediatrics*. 2020; doi:10.1001/jamapediatrics.2020.4573.
6. COVID-19 vaccine: Frequently asked questions. American Academy of Pediatrics. <https://services.aap.org/en/pages/2019-novel-coronavirus-covid-19-infections/covid-19-vaccine-frequently-asked-questions/compared-to-adults-a-systematic-review-and-meta-analysis>. *JAMA Pediatrics*. 2020
7. Interim statement on COVID 19 vaccination for children and adolescents, WHO. Last updated 24.11.2021. <https://www.who.int/news/item/24-11-2021-interim-statement-on-covid-19-vaccination-for-children-and-adolescents>